



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Projektet Sociale –viti 2024

Financim për shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa- Fond i kushtëzuar i Ministrisë së Shëndetësisë

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2024, bazuar ne VKQ nr.21 date 28.12.2023, në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetë qeverisjen vendore”, Ligjin nr. 97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024” pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017” Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 ” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ka parashikuar ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç, në shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, në programin 10430, Art 6060000, shpenzime korente, shumën **7,465,196 lekë**.

Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, ushtron aktivitetin e saj prej 26 vitesh dhe strehon persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social-rezidencial për persona me aftësi të kufizuara.

Shërbimet që ofrohen në qendër janë;

- Shërbimi rezidencial;
- Shërbimi mjekësor;
- Shërbimi psiko-social;
- Aktivitete social-kulturore, vizita;
- Shërbimi sanitar.

- ***Financim për qendrën ditore Buzëqeshja e Motër Lezes, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa- Fond i kushtëzuar i Ministrisë së Shëndetësisë***

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2024, bazuar ne VKQ nr.21 date 28.12.2023, në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetë qeverisjen vendore”, Ligjin nr. 97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024” pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017” Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 ” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ka parashikuar ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror ditor për persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç, projekti **Buzëqeshja e Motër Lezes** , ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, në programin 10430 ,Art 6060000,

shpenzime koherente, shumën **7,6321,283 lekë**.

- ***Financim për Shtëpi - Familje*** , ofruar nga ***”Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionaret e Dashurisë Kontemplative”*** ,Fond i kushtëzuar i Ministrisë së Shëndetësisë

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2024, bazuar ne VKQ nr.21 date 28.12.2023, në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetë qeverisjen vendore”, Ligjin nr. 97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024” pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017” Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 ” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, ka parashikuar ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara ”Financim për Shtëpi - Familje” , ofruar nga ***”Shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionaret e Dashurisë Kontemplative”*** në programin 10430 ,Art 6060000, shpenzime koherente, shumën **7,786,372 lekë**.

Përfshirja në jetën social- kulturore të moshës së tretë

Ky projekt synon që të përfshijë në jetën social-kulturore subjektet e rezidencave publike të kësaj kategorie.

A1-Dita Botërore e të moshuarve 1 TETOR

A2-Fuqizimi dhe mbulimi me internet i gjithë hapësirës së godinës së shtëpisë së moshuarve

A3-Vizitë tek shtëpia e të moshuarve në Tiranë, apo vizita muazeale, shkëmbim idesh dhe bashkëjetesë.

Vlera totale e projektit 190,000 lekë

Mbështetje e Shoqatës së të Verbërve

Këshilli i Qarkut Shkodër çdo vit, sipas pikës 12 VKM nr. 277 datë 19.06.2023, financon Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë Dega Shkodër në vlerën prej **200,000 Lekësh**.

Integrim i personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë

Shoqata e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë ka parashtruar nevojën e disa aktiviteteve të domosdoshme që mund të realizohen gjatë vitit.

- Dy eskursione në vende turistike të Shkodrës;
- Organizimi i kampeve Verore;
- Kampionat Shahu dhe Domino për moshën e tretë;
- Organizim i eventeve të vogla (festa ditëlindje)

Vlera totale e projekti 60,000 lekë